

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.05.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Pajimet dhe sinjalizimi trafikut rrugor “ , Nr. i prokurimit- 632-21-8848-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-21-147-111, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, e dt.04.05.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit Pajimet dhe sinjalizimi trafikut rrugor “ , Nr. i prokurimit- 632-21-8848-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-21-147-111., kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 28.04.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 28.04.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.04.05.2022, Operatori Ekonomik N.SH.T. “ VIKTORY COM”, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **Pajimet dhe sinjalizimi trafikut rrugor “ , Nr. i prokurimit- 632-21-8848-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-21-147-111.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.05.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit se ju keni ofruar sqarime për të gjitha pikat, ju njoftojmë se ky pretendim i juaji nuk qëndron për shkak se:

- Në sqarime në lidhje me çmimet e ofertuara ju keni ofruara vetëm një deklaratë të pa mbështetur e cila konsiderojmë se është jo bindëse, ku lidhja eventuale e një kontrate me këto çmime mund të rezultojë në shkëputje të parakohshme të kontratës e cila e rrezikon mos realizimin e projektit si dhe ju rrezikon juve si operatorë që të përfshihen në listën e operatorëve të pa përgjegjshëm.

- Pas kërkesës për sqarime, Ju nuk keni ofruar dëshmi që te na tregoni saktësisht se cili produkt i përgjigjet pozicionit sipas specifikacioneve teknike “Aneksi 1-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”, se bashku me të gjitha kërkesat për certifikata sipas këtij aneksi.

Per produktet si ne vijim:

5. Ekranet e informimit te trafikut (VMS – Variable Message Sign)

6. Pajisje sinjalizuese për rritjen e sigurisë ne vendkalime

9. Pajime te trafikut rrugor

10. Radar vetëdijesues shpejtësisë

- Ndërsa për produktet që keni ofruar katalogë dhe certifikata pas krahasimit dhe ekzaminimit të tyre kemi konstatuar se nuk i plotësojnë kriteret minimale siç janë kërkuara në “Aneksi 1-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”.
- Autorizimi i ofruar nga distributori Eko-Inves është autorizim i distributorit ndërsa mungon dëshmia që EKOINVEST është distributor i autorizuar nga La Semaforica
- Edhe pse AK ju ka dhënë afat shtesë për dorëzimin e sqarimeve ju nuk keni ofruara sqarime të mjaftueshme dhe bindëse sipas kërkesave të FDT-ës.

Sa i përket pretendimit se as një operator nuk ka ofruar ISO certifikata për sinjalizimin rrugor, ju njoftoj se pretendimi i juaj nuk qëndron për shkak se:

- OE i rekomanduar për këtë kontratë, ka dorëzuar ISO standarde si pikë e veçantë dhe katalogje të detajuara për secilin produkt, ku këto katalogje kanë të bashkangjitura certifikata të EN dhe ISO standardeve siç janë kërkuar në ANEKSIN 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Sa i përket pretendimit se OE Intrast shpk ka shumë mungesa të materialeve të ngjashme siç është Radari i Këmbësorëve tek Shkollat i cili sipas jush nuk është i njëjtë me atë që është kërkuar nga AK, ju njoftoj se pretendimi i juaj nuk qëndron për shkak se:

- Fillimisht ju bëj me dije se AK nuk ka kërkuar radar për këmbësorë tek shkollat, sepse nuk është problem shpejtësia e lëvizjes së këmbësorëve por e automjeteve! Pra, AK ka kërkuar radar për matjen e shpejtësisë së automjeteve e jo të këmbësorëve.
- OE Intrast shpk, ka prezantuar radarin e prodhuesit SWARCO, tipi: SPEED LUX 320 + matrix display XK, i cili është në përputhje me pikën 6.5 ‘‘Radar vetëdijesues shpejtësisë’’ të ANEKSIT 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Sa i përket pretendimit se ju keni ofertuar me dy lloje të radarëve ju njoftojmë se:

- Ofertimi i juaj për këtë produkt nuk është në përputhje me kërkesat minimale siç janë kërkuar në FDT.
- Edhe pas kërkesës për sqarime shtesë ju keni dështuar që të ofroni sqarime për radarët vetëdijesues. (shiko përgjigjen e pretendimit 1)

Sa i përket pretendimit se as një operator nuk ka katalogë të produkteve përveç OE Viktory com dhe Marisa shpk, ju njoftoj se pretendimi i juaj nuk qëndron për shkak se:

- Të gjithë ofertuesit kanë prezantuar kataloge të produkteve, mirëpo vetëm OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalogë të produkteve të cilat plotësojnë kërkesat e FDT-ës.

Sa i përket pretendimit se ju keni ofertuar në bazë të çmimeve që ju kanë dhënë dillerët e kompanive që janë të autorizuar në Kosovë dhe çmimet e ofruara nga ju janë të njëjta me konkurrent tjerë, ju njoftoj se pretendimi i juaj nuk qëndron sepse:

- Po të ishin çmimet e njëjta me ofertuesit tjerë, oferta juaj nuk do të ishte abnormalisht e ulët, e cila është nën 30% të vlerës mesatare të gjitha ofertave.

Sa i përket pretendimit se inxhinier i komunikacionit z. Mulaj i ofruar nga ju, ka bërë projekte të komunikacionit dhe semaforëve, ju njoftojmë se pretendimi i juaj nuk qëndron sepse:

- Fillimisht po ju njoftoj me kërkesën e saktë për inxhinierin e trafikut i cili është kërkuar që të jetë: me përvojë pune në instalimin e pajisjeve semaforike dhe në sinjalizimin horizontal dhe vertikal të rrugëve.
- Në bazë të CV-is së prezantuar menaxheri juaj nuk ka përvoja e punës në instalimin e pajisjeve semaforike. Në sqarime ju keni dhënë një deklaratë ku keni thënë se z. Mulaj ka përvojë në disa projekte të Komunës së Prishtinës për mbikëqyrje dhe projektim të sinjalizimi, në CV këto projekte kanë tituj të ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve, ndërsa

ju nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme për një përvojë pune siç është kërkuar në FDT.

Sa i përket pretendimeve tuaj në lidhje me operatorët vendor, në lidhje me nenin 13 të ligjit për rimëkëmbje nr. 07/L-016, ju njoftoj se të gjithë ofertuesit janë operator vendor, pra janë të regjistruar dhe operojnë në Republikën e Kosovës.

- Ju nuk keni ofruar produkte të cilat i prodhoni vet, prandaj ju si operator nuk jeni prodhues, ndërsa të gjithë konkurrentët tuaj janë operator vendor, pra të Republikës së Kosovës.

Të gjitha dosjet e ofertuesve janë kontrolluar detajisht, ndërsa ju si OE që keni disa kontrata me Komunën e Gjakovës, nuk keni ofruar referenca që keni kryer punë të ngjashme siç kërkohet në FDT. Përveç që nuk keni ofruar referenca dhe kontrata, për ne jeni të njohur që ju nuk keni kryer asnjëherë këtë lloj të punës siç kërkohet në FDT-ën në bazë të së cilës keni ofertuar.

- Oferta e juaj është abnormalisht e ulët pasi është nën 30% të vlerës mesatare të gjitha ofertave.

- Oferta e juaj përmban çmime abnormalisht të ulëta të cilat në treg janë shumë më të larta se sa që ju keni ofertuar, në sqarime në lidhje me këtë pikë ju keni ofruara vetëm një deklaratë të pa mbështetur e cila konsiderojmë se është jo bindëse.

Ju keni ofertuar tek pjesa A SEMAFORËT në pozicionet: 1, 2, 3, 25, 28, 29, 30 me çmime shumë të ulëta në krahasim me vlerën që kanë në treg si të tilla nuk janë aspak reale, në sqarime në lidhje me këtë pikë ju keni ofruara vetëm një deklaratë të pa mbështetur e cila konsiderojmë se është jo bindëse.

Ju keni ofertuar tek pjesa B VMS - EKRANI I INFORMIMIT TË TRAFIKUT DHE SINJALIZIMI NDRIÇUES PËR VENDKALIMIN E KËMBËSORËVE në pozicionet: 2, 3, 4, 5, 6, 7, 15, 16, 17, 18. me çmime shumë të ulëta në krahasim me vlerën që kanë në treg si të tilla nuk janë aspak reale, në sqarime në lidhje me këtë pikë ju keni ofruara vetëm një deklaratë të pa mbështetur e cila konsiderojmë se është jo bindëse.

Ju keni ofertuar tek pjesa E PAJISJET RRUGORE në pozicionet: 14, 15, 16, 17, 18, 19, 22, 23 me çmime shumë të ulëta në krahasim me vlerën që kanë në treg si të tilla nuk janë aspak reale, në sqarime në lidhje me këtë pikë ju keni ofruara vetëm një deklaratë të pa mbështetur e cila konsiderojmë se është jo bindëse.

Ju njoftojmë se AK ka në plan që përmes kësaj kontrate të rregulloj/ndërroj në tërësi pajisjet për paktën tre udhëkryqe me semafor, të vendos të paktën 4 vende me shtylla hidraulike për menaxhimin e shehsheve, të vendos të paktën 2 ekrane VMS, të ndriçoj të paktën 10 vend kalime për këmbësorë, të vendos të paktën 6 radar.

Në të gjitha këto pozicione ju keni ofruar me çmime shumë të ulëta në krahasim me vlerën reale në treg, për këtë ju është kërkuar sqarim ndërsa ju, në sqarime në lidhje me këtë pikë ju keni ofruara vetëm një deklaratë të pa mbështetur e cila konsiderojmë se është jo bindëse, ku lidhja eventuale e një kontrate me këto çmime mund të rezultojnë në shpërbërje të parakohshme të kontratës e cila e rrezikon mos realizimin e projektit si dhe ju rrezikon juve si operatorë që të përfshihen në listën e operatorëve të pa përgjegjshëm.

- Ju si OE keni ofruara kontrata të ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve dhe kontrata të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra, ndërsa nuk keni dëshmuar se keni përfunduar me

sukses kontrata, siç është kërkuar në dosje të tenderit pika 9.1 & 9.2 si dhe siç është sqaruar në sqarimet shtesë të publikuara në platformën e e-prokurimit (shiko sqarimet shtesë në platformë). Në sqarimet shtesë nuk keni ofruar fakte se keni kryer punë siç është kërkuara në FDT.

- Në pikën 9.1 & 9.2 është kërkuar që të keni një projekt menaxher i cili duhet të jetë Inxhinier i Inxhinierisë Mekanike ose master drejtimi komunikacion (trafik dhe transport rrugor) - me përvojë pune në instalimin e pajisjeve semaforike dhe në sinjalizimin horizontal dhe vertikal të rrugëve (së paku 5 vite përvojë pune). Në bazë të CV-is së prezantuar menaxheri juaj nuk ka përvoja e punës në instalimin e pajisjeve semaforike. Në sqarime ju keni dhënë një deklaratë ku keni thënë se z. Mulaj ka përvojë në disa projekte të Komunës së Prishtinës për mbikëqyrje dhe projektim të sinjalizimi, në CV këto projekte kanë tituj të ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve, ndërsa ju nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme për një përvojë pune siç është kërkuar në FDT.
- Ju keni ofruar certifikata e kataloge gjenerale për produktet e kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit,

Edhe pas kërkesës për sqarime, Ju nuk keni ofruar dëshmi që të na tregoni saktësisht se cili produkt i përgjigjet pozicionit sipas specifikacioneve teknike “Aneksi 1-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”, se bashku me të gjitha kërkesat për certifikata sipas këtij aneksi.

Per produktet si ne vijim:

5. Ekranet e informimit të trafikut (VMS – Variable Message Sign)

6. Pajisje sinjalizuese për rritjen e sigurisë në vendkalime

9. Pajime të trafikut rrugor

10. Radar vetëdijesues shpejtësisë


Ndërsa për produktet që keni ofruar katalogë dhe certifikata pas krahasimit dhe ekzaminimit të tyre kemi konstatuar se nuk i plotësojnë kriteret minimale siç janë kërkuara në “Aneksi 1-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”.


- Autorizimi i ofruar nga distributori Eko-Inves është autorizim i distributorit ndërsa mungon dëshmia që EKOINVEST është distributor i autorizuar nga La Semaforica

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës